



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 57/2021 (JR)  
Nr. 57/ 2 regj.

Tiranë më 8.11.2024

**SHPALLJE**

**E**

**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e enjte, **datë 05.12.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, çështja me nr. regjistri (JR) 57/2021, datë 11.10.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Iliopullo kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 420, datë 13.07.2021.

Seanca gjyqësore në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor, përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e Trupit Gjyqësor**  
**Relator i Çështjes**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**

**Natasha Mulaj**  
**Sokol Çomo**  
**Ina Rama**  
**Albana Shtylla**  
**Mimoza Tasi**

Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYQËSOR**  
**GJYQTARE**

**NATASHA MULAJ**

